



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE E INTEGRIMIT

Nr. 9145/ Prot.
3

Tiranë, më 07.01.2020

Lënda: Njoftim

OPERATORIT EKONOMIK "DOGEL" SHPK

Adresa: Fshati Çarçovë, Gjirokastrë.

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP"), në mbështetje të kërkesës së Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, me shkresën Nr. 9145/1 Prot., datë 02.12.2019 ka nisur procedimin administrativ ndaj operatorit tuaj ekonomik, për përjashtimin tuaj nga pjesëmarrja në prokurimet publike, në mbështetje të nenit 13/3/a të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Po me këtë shkresë, ju është kërkuar të paraqisni pretendimet me shkrim, së bashku me dokumentacionin shoqërues të njehsuar dhe argumentimet përkatëse që mund të keni për çështjen në fjalë brenda 15 ditëve nga marrja e kësaj shkrese.

Në kushtet kur, operatori juaj ekonomik nuk ka dërguar asnjë dokumentacion në përgjigje të shkresës së sipërcituar, APP me shkresën Nr. 9145/2 Prot., datë 24.12.2019 ju ka rikujtuar dërgimin e pretendimeve tuaja, **brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e kësaj shkrese**, pasi në të kundërt APP do të vijonte me procedimin administrativ në bazë të dokumentacionit të administruar.

Kjo shkresë nuk ka shkuar në destinacion dhe është kthyer mbrapsht nga Posta Shqiptare me pretendimin se, shoqëria është larguar në Tiranë.

Ndërkohë, nga verifikimi i Ekstraktit Historik të shoqërisë "Dogel" Shpk në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, nuk rezulton të ketë ndryshim adrese nga ajo e vendit të ushtrimit të aktivitetit.

Sa më sipër, nëpërmjet këtij njoftimi publik, APP njofton shoqërinë tuaj për dërgimin e pretendimeve tuaja me shkrim së bashku me dokumentacionin shoqërues të njehsuar dhe argumentimet përkatëse që mund të keni për çështjen në fjalë, **brenda 3 (tre) ditëve nga**

publikimi i këtij njoftimi, pasi në të kundërt APP do të vijojë me procedimin administrativ në bazë të dokumentacionit të administruar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

